



Public Procurement Agency  
Agjensia e Prokurimeve Publike

# RAPORTI VJETOR 2013

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2013 deri në Dhjetor 2013.

Agjencia e Prokurimit Publik  
Blv. "D. Kombit" Nr.1, Tirane, Albania  
Tel. + 355 4 22 77 510  
E-mail. [info.app@app.gov.al](mailto:info.app@app.gov.al)  
<https://www.app.gov.al>



# PËRMBAJTJA

1. HYRJE _____	5
2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA _____	6
3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2013 _____	6
4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2013 _____	8
5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE. _____	9
6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2013 _____	11
7. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E NJOFTIMEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË SHPALLURA GJATË VITIT 2013 _____	16
8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E _____	19
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	
9. TREGUESIT E VEPRIMTARISË NË DREJTIM TË INTEGRIMIT, MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS _____	29
10. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT _____	36
11. PËRMBYLLJE _____	36


# 1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2013 deri në 31 Dhjetor 2013.

Gjatë vitit kalendarik 2013, Agjencia e Prokurimit Publik e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr.9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9663/2006 “Për konçesionet”, i ndryshuar, i cili u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”,

Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar si dhe në bazë të Urdhërit të Kryeministrit Nr.143, datë 06.07.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr.80, datë 30.01.2013 “Për rialokimin e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2013”..

Konkretisht, struktura e APP-së është si më poshtë:



## 2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Agjencia e Prokurimit Publik përgjatë 6 mujorit të parë të këtij viti, ka qenë e përfshirë në zbatimin e programit Trajnim për Trajnerë në prokurimin publik, në kuadër të projektit të financuar nga BE "Trajnimi në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi". Në kuadër të këtij Projekti, u bë i mundur përfundimi i Trajnimit për Trajnerë për personat e trajnuar në fazën e dytë të programit. Në këtë fazë të fundit, me asistencën e projektit në fjalë, personat e trajnuar për trajnerë, u testuan si lektorë në 5 seanca trajnimi me fokus në prokurimin publik, të zhvilluara gjatë periudhës Prill-Maj 2013. Në kuadër të këtij projekti, APP u përfshi dhe në përgatitjen e një udhërrëfyese, në mbështetje të

organizimit të trajnimeve për prokurimin publik në të ardhmen, në vend.

Edhe gjatë vitit 2013, sikurse dhe në vitet paraardhëse, Agjencia e Prokurimit Publik, ka vazhduar të asistohet nga SIGMA (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qëndrore dhe Lindore) për përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadër të procesit të integritetit evropian. Gjatë këtij viti, asistenca e SIGMA-s ka qenë e fokusuar në hartimin e legjislacionit parësor dhe atij dytësor për konçesionet dhe partneritetin publik privat, si dhe në hartimin e një strategjie për sistemin e prokurimit publik në tërësi, në Shqipëri.

## 3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2013

### 3.1. Ndryshimet legjislative

Në kuadër të detyrimit për përafrimin me *Acquis* e Bashkimit Evropian të legjislacionit të koncesioneve si dhe detyrimit për rregullimin me ligj të partneritetit publik privat, rekomandime këto të dala shprehimisht dhe nga Progres Raportet e Komisionit Evropian, gjatë vitit 2013, me asistencën e SIGMA-s (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qëndrore dhe Lindore), Agjencia e Prokurimit Publik përgatiti dhe dërgoi për miratim projektligjin "Për konçesionet dhe partneritetet publike private". Ky projektligj u miratua nga Parlamenti me Ligjin Nr.125/2013 "Për konçesionet

dhe partneritetin publik privat" dhe ka hyrë në fuqi më 25 Maj 2013, duke përmbushur kështu një nga rekomandimet e BE-së në fushën e prokurimit publik.

Konkretisht ky ligj përafrohet me dispozitat respektive të Direktivës 2004/18/EC të cilat i referohen konçesionit dhe PPP-ve kryesisht në drejtim të procedurave konkurruese të ndjekura dhe afateve ligjore respektive. Në këtë ligj, për herë të parë u ndanë qartë fazat e procedurave konçesionare dhe PPP-ve, si dhe kompetencat e institucioneve kryesore të përfshira në këtë proces.

### 3.2. Iniciativat nënligjore të APP-së

Në kuadër të ndryshimeve ligjore të bëra në vitin 2012 në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në fillim të vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik, përgatiti dhe dërgoi për miratim draftin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1/2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, i cili pasqyronte dhe rregullonte respektivisht ndryshimet e LPP-së. Gjithashtu në kuadër të rritjes së transparencës në

procedurat e prokurimit, dhe uljes së mundësive për abuzim, APP hartoi dhe dërgoi për miratim draft vendimin për ndryshimin e VKM-së nr.45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit me mjete elektronike". Më konkretisht nëpërmjet projektvendimit të propozuar synohej lehtësimi i procedurave për kryerjen e prokurimeve me vlerë të vogël, rritja e transparencës dhe nxitja e pjesëmarrjes së operatoreve ekonomike në këto prokurime.

Ndryshimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për procedurat e prokurimit publik, u shoqërua me ndryshimin e paketës së Dokumentave Standardë të Tenderit si dhe me udhëzime më të detajuara të përgatitura dhe të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Këto të fundit ndahen në dy kategori kryesore; në udhëzime të karakterit ligjor, të cilat u vijnë në ndihmë Autoriteteve Kontraktore në kuptimin dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit të prokurimit publik, dhe në udhëzime të karakterit teknik, të cilat u vijnë në ndihmë Autoriteteve Kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për zhvillimin e procedurave të prokurimit në sistemin elektronik.

Gjithashtu, ndryshimet në ligj në fushën e konçesioneve realizuar në bashkëpunim me SIGMA-n, sollën nevojën e plotësimit të kuadrit ligjor me legjislacionin dytësor në zbatim të ligjit

### ➤ **Prokurimi publik:**

Ndryshimet në Rregullat e Prokurimit Publik janë finalizuar me miratimin e Vendimit Nr.32, Datë 23.01.2013 të Këshillit të Ministrave.

Mbi këtë bazë, Agjencia e Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit Nr. 1, datë 01.02.2013 miratoi setin e ri të Dokumentave Standarte të Tenderit, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike, për secilën prej procedurave të prokurimit, të parashikuara në ligjin e prokurimit publik.

Gjatë gjithë vitit 2013, për t'u ardhur sa më shumë në ndihmë autoriteteve kontraktore, APP-ja ka hartuar Udhëzimet si më poshtë:

1-Udhëzimin Nr. 1, datë 01.02.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", ndryshuar më pas me Udhëzimin Nr.02, datë 28.03.2013 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013. Nxjerrja e këtyre udhëzimeve u diktua nga ndryshimet e bëra në Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe detyrimit të autoriteteve kontraktore për realizimin e këtyre procedurave nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve.

1-Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/partneritet publik privat;

2-Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 576, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për

të ri "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat". Për këtë, si rezultat i po këtij bashkëpunimi u hartuan dy projekt-vendimet "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion dhe partneritet publik privat" si dhe "Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet"

Konkretisht aktet nënligjore të miratuara gjatë vitit 2013 për prokurimin publik dhe koncesionet/ppp-të, paraqiten si më poshtë:

Konkretisht ky ligj përafrohet me dispozitat respektive të Direktivës 2004/18/EC të cilat i referohen konçesionit dhe PPP-ve kryesisht në drejtim të procedurave konkurruese të ndjekura dhe afateve ligjore respektive. Në këtë ligj, për herë të parë u ndanë qartë fazat e procedurave konçesionale dhe PPP-ve, si dhe kompetencat e institucioneve kryesore të përfshira në këtë proces.

2-Udhëzimin Nr. 03, Datë 28.06.2013 Për dorëzimin e ofertës në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël nga operatorët ekonomikë". Ky udhëzim është hartuar për t'i ardhur në ndihmë, duke sqaruar teknikisht, operatorët ekonomikë të interesuar për të ofertuar në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të cilat, realizohen në sistemin elektronik të prokurimeve.

3-Udhëzimin Nr.4, Datë 04.07.2013 "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë". Me anë të këtij udhëzimi sqarohen autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë mbi mënyrën se si duhet të procedojnë në sistemin elektronik të prokurimeve, në zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

4-Udhëzimin Nr.6, Datë 03.09.2013 "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shërbimet e përkujdesjes shoqërore". Ky udhëzim është hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik për t'i ardhur në ndihmë të gjitha autoriteteve kontraktore, të cilat, prokurajnë shërbimet e përkujdesjes shoqërore.

identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e konçesioneve për hidrocentralet";

3-Vendim i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 19.07.2013 "Për miratimin e dokumentave standarde të konçesioneve dhe partneritetit publik

privat për kontratat e shërbimeve dhe punëve publike”.

Një pjesë e konsiderueshme e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore të propozuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, synonin rregullimin ligjor dhe

përmirësimin e disa situatave të krijuara në praktikë, situata këto të cilat janë evidentuar nga Agjencia e Prokurimit Publik nëpërmjet mekanizmave të saj për monitorimin e sistemit, siç janë statistikat e nxjerra nga platforma elektronike, praktikat e përcjella nga institucionet audituese, trajnimet etj.

### 3.3. Iniciativat nënligjore në proces

Pasur në konsideratë ndryshimet legjislative për procedurat koncesionare dhe PPP-të, si dhe shfuqizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të mëparshme në këtë drejtim, me qëllim sanksionimin në legjislacionin dytësor të detyrimit për kryerjen në formë elektronike, nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit,

të fazës së parë të procedurave koncesionare dhe ppp-ve, Agjencia e Prokurimit Publik gjatë vitit 2013 ka hartuar dhe propozuar në Këshillin e Ministrave për miratim një projekt vendim për “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies me koncesion dhe ppp-të”.

## 4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2013. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Sfidat kryesore me të cilat është përballur Agjencia e Prokurimit Publik, gjatë vitit 2013, kanë konsistuar kryesisht në përmirësimin e kuadrit legjislativ të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneritetit publik privat, në drejtim të përafrimit të mëtejshëm me parashikimet respektive të direktivave të BE-së, në rritjen maksimale të transparencës në procedurat e prokurimit nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të platformës elektronike dhe përfshirjes në të dhe të prokurimeve me vlerë të vogël me vlerë mbi 10.000 mijë lekë, si dhe ngritja e kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Përmirësimi i legjislacionit në këtë fushë, për të cilin APP është angazhuar maksimalisht, përveçse një detyrë ligjore e kësaj të fundit, është njëkohësisht edhe një detyrë që vjen nga detyrimet e marra përsipër në kuadër të procesit të integritetit dhe më konkretisht të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. Për shkak të ndryshimeve në legjislacionin e prokurimit publik në fund të vitit 2012, sikurse është përshkruar dhe më sipër, në fillim të vitit 2013, APP-ja u përball me sfidën e përgatitjes së paketës së plotë të legjislacionit dytësor, dhe dërgimin e saj për miratim në Këshillin e Ministrave, si dhe

me hartimin e vendimeve dhe udhëzimeve të saj, në funksion të këtyre ndryshimeve. Të gjitha këto akte nënligjore u përgatitën në një kohë shumë të shkurtër, për të mos krijuar boshllëqe ligjore të cilat do të pengonin Autoritetet Kontraktore në kryerjen e procedurave të prokurimit.

Po kështu dhe përgatitja e paketës ligjore për koncesionet dhe partneritetin publik privat, ishte një tjetër sfidë për APP-në. Kjo si për periudhën relativisht të shkurtër gjatë të cilës u përgatitën këto akte ligjore dhe nënligjore, përfshi këtu dhe paketën e dokumentave standardë të koncesionit/ ppp-ve, ashtu dhe për mungesën e stafit të mjaftueshëm për këtë qëllim.

Në lidhje me procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të prokurimit elektronik, APP, gjatë këtij viti ka punuar intensivisht për ngritjen e kapaciteteve të sistemit si në pjesën operacionale ashtu dhe në atë të arkivës. Megjithatë sfida më e madhe e APP-së në këtë drejtim ka qënë dizenjimi dhe realizimi në sistemin e prokurimit elektronik, të prokurimeve me vlerë të vogël.

Një tjetër sfidë gjatë këtij viti ka qënë edhe hartimi i udhëzimeve përkatëse, për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, në lidhje me çdo

funksionalitet të ri të krijuar në sistem sidomos për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël si dhe trajnimi i Autoriteteve Kontraktore mbi zbatimin

e legjislacionit të prokurimit publik, në kushtet kur ky legjislacion kishte pësuar ndryshime të rëndësishme.

## **5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE.**

### **5.1. Bashkëpunimi i APP-së me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së**

**G**jatë vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në takime ndërkombëtare, kanë zhvilluar vizita në disa nga vendet e rajonit dhe të BE-së, si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare.

Një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP-ja ka vazhduar të ketë me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore), një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me të cilën gjatë këtij viti ka punuar ngushtësisht për hartimin e një draft ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat. Për këtë qëllim me përfaqësues të SIGMA-s janë zhvilluar një sërë takimesh dhe organizuar tryeza pune, produkt i të cilave është miratimi i projektligjit dhe sanksionimi i tij në Ligjin Nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

Gjithashtu, gjatë këtij viti, Agjencia e Prokurimit Publik ka bashkëpunuar me SIGMA-n edhe në kuadër të përgatitjes së një dokument-studimi mbi zhvillimin e prokurimeve të përqëndruara në Shqipëri. Në këtë drejtim, për të patur një kuptim më të mirë mbi funksionimin e prokurimeve të përqëndruara në praktikë, u organizuan disa takime me përfaqësues të autoriteteve kontraktore, të

cilat për nevojat e tyre prokurojnë më së tepërmi mallra apo shërbime nëpërmjet Organit Qendror Blerës.

Po në kuadër të bashkëpunimit me SIGMA-n, gjatë vitit 2013, ka filluar puna për përgatitjen e një strategjie kombëtare në fushën e prokurimit publik.

Gjatë këtij viti, APP ka bashkëpunuar, me ekspertë të caktuar për këtë qëllim, në kuadër të monitorimit ex post të projektit të binjakëzimit IPA 2008 "Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik", implementimi i të cilit përfundoi në muajin Janar 2012. Ky monitorim kishte kryesisht për qëllim të vlerësonte impaktin dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve të realizuara nga projekti i lartpërmendur, gjatë periudhës së tij të zbatimit.

Ndërkohë, përsa i përket projektit tjetër të financuar nga BE "Trajnimi në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi", i cili ka vazhduar të implementohet edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2013, APP ka bashkëpunuar me përfaqësuesit e këtij projekti, përveç të tjerash, edhe në drejtim të zhvillimit të takimit të fundit të Komitetit Drejtues, i cili u zhvillua në muajin Qershor, në Torino, Itali.

Gjatë kësaj periudhe, APP ka patur bashkëpunim edhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe



Zhvillim (BERZH). Në fokus të këtij bashkëpunimi ishte pasqyrimi i reformave më të fundit në fushën e prokurimit publik, me qëllim inkurajimin dhe

dhënien e udhëzimeve për reforma të ardhshme në vendet ku BERZH operon.

## 5.2. Bashkëpunimi i APP-së me institucione të tjera në Shqipëri

**E** gjatë vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik ka patur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga APP-ja janë dhënë sqarime dhe këshilla për këto institucione, kur janë kërkuar, me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, si dhe janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve në këtë drejtim. Gjatë këtij viti komunikimet kanë qënë edhe më intensive për shkak të ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe kryerjes për herë të parë të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në formë elektronike.

Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP-ja ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2013, me Ministrinë e Integritimit. Në mënyrë periodike, në Ministrinë e Integritimit është raportuar progresi i APP-së në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA-së në fushën e prokurimeve publike. Me këtë Ministri janë realizuar takime të shpeshta që kanë pasur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në kuadër të integritimit.

Bashkëpunim shumë të mirë dhe të suksesshëm gjatë vitit 2013 APP-ja ka pasur dhe me ish- Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike (ITAP), në bashkëpunim me të cilin ka realizuar 20 seanca trajnime për Autoritetet Kontraktore me qëllim njohjen e tyre me ndryshimet e kuadrit ligjor dhe përmirësimet e sistemit të prokurimit elektronik. Po kështu bashkëpunimi me këtë institucion ka vazhduar në kuadër të implementimit të fazës së fundit të projektit të financuar nga BE "Trajnimi në

prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi".

Një tjetër bashkëpunim mjaft pozitiv gjatë vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim evidentimin dhe penalizimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit nga autoritete të ndryshme kontraktore. Gjithashtu në kuadër të njohjes së përfaqësuesve të këtij institucione me ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit, gjatë vitit 2013, përfaqësues të APP-së janë aktivizuar në seanca trajnime të organizuara nga SIGMA.

Gjatë vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, ka pasur bashkëpunim edhe me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Në bazë të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, KPP-ja ka njoftuar APP-në në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrimin në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP-ja, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.

Të dy institucionet kanë bashkëpunuar edhe në kuadër të raportimeve në Ministrinë e Integritimit mbi detyrimet në këtë drejtim në fushën e prokurimit publik, në të gjitha ato raste ku raportimet janë kërkuar në nivel të Kapitullit 5 "Prokurimi Publik".

## 6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2013

### 6.1. Tregues të veprimtarisë së drejtorisë juridike, monitorimit dhe publikimit

Veprimtaria e Drejtorisë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë kësaj periudhe është fokusuar në hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore respektivisht në fushën e prokurimit publik dhe koncesioneve/ppp-ve, në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin

e propozimeve për përjashtimin nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike apo procedurat e ankandeve, të shoqërive të ndryshme, trajnimin e përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktore etj.

Më konkretisht, gjatë vitit 2013 Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit e përqëndroi veprimtarinë e saj në këto drejtime kryesore:

#### 6.1.1. Ndryshimet legjislative

Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë vitit 2013, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për përmirësimin e legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe PPP-ve, si dhe për nxjerrjen e një sërë udhëzimesh për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuadër, kjo drejtori gjatë vitit 2013 ka luajtur rolin kryesor në përgatitjen e ndryshimeve në aktet dytësore për prokurimin publik, përgatitjen e projektligjit për koncesionet dhe ppp-të, si dhe projekt aktet dytësore në këtë drejtim, sikurse janë listuar më sipër në këtë analizë.

#### 6.1.2. Praktikave të shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshillash apo udhëzimesh

Gjatë këtij viti, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, në zbatim të detyrave që i ngarkon ligji nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik,, i ndryshuar, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike, koncesionet/ppp-të, apo ankandet të shoqërive të ndryshme, shqyrtimin e praktikave të auditimit, të përcjella nga institucionet audituese dhe monitorimin e procedurave të prokurimit.

Më konkretisht të dhënat në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave paraqiten si më poshtë:

Asistenca e kësaj drejtorie, ndër të tjera, është përqëndruar në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Në muajt e parë të vitit 2013, me miratimin e ndryshimeve të Rregullave të Prokurimit Publik, si pasojë e ndryshimeve në ligjin e prokurimit publik, nxjerrjen e Dokumentave Standarte të Tenderit, sipas këtyre ndryshimeve, mendimet dhe sqarimet e ndryshme për palët e përfshira në procesin e prokurimit kanë konsistuar pikërisht në këtë drejtim.

Përveç sa më sipër, një numër i konsiderueshëm kërkesah për mendime janë fokusuar në mënyrën e

procedimit për prokurimet me vlerë të vogël, të cilat, gjatë vitit 2013 janë realizuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve.

Gjatë muajit korrik e në vijim, kjo drejtori ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për mendim nga autoritetet kontraktore, të cilat, kanë konsistuar kryesisht në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur, me VKM-në nr.591, datë 10.07.2013 te Këshillit të Ministrave „Per disiplinimin e perdorimit te shpenzimeve buxhetore per vitin 2013”, pas datës 15 korrik 2013, botimi i çdo lloj njoftimi për prokurim të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale dhe korrente të njësive të qeverisjes së përgjithshme, sipas përcaktimeve në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhej vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit kalendarik, kjo drejtori ka patur edhe kontakte shkresore me institucione të ndryshme si; Prokuroritë

e Rretheve Gjyqësore në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit, me institucionin e Avokatit të Shtetit mbi proceset gjyqësore që perfaqësojnë Agjencinë e Prokurimit Publik në cilësinë e palës së paditur apo operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në këtë drejtori për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/ppp-ve, gjatë vitit 2013 kanë qënë rreth 200.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, kjo drejtori ka dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP-së. Numri total i praktikave, për të cilat, kjo drejtori ka dhënë mendime për projektvendime të ndryshme, gjatë vitit 2013 ka qënë 13.

### 6.1.3. Gjobat dhe masat disiplinore

Një nga kompetencat kryesore të kësaj Drejtorie gjatë vitit 2013, ka qënë dhe shqyrtimi i rekomandimeve të institucioneve audituese, për marrje masash në rast shkeljesh të konstatuara në procedura të ndryshme prokurimi. Në përfundim të hetimeve administrative, raporteve

të dërguara nga KLSH, institucionet audituese në vend, apo monitorimet e kryera nga vetë APP-ja, në ushtrim të detyrave të saj, nga kjo drejtori janë vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa ndëshkuese ndaj personave përgjegjës si më poshtë:

Masa Disiplinore	Gjoba	Tërheqje vëmendje	Plotësim dokumentacioni	Kërkesë për rishikim vendimi
40	12	26	15	4

#### GJOBA

Nga Hetimi administrativ i APP-së	Nga auditimet e KLSH-së	Nga Auditet e Brendshme të Autoriteteve	Nga vendimet e KPP-së
3	5	2	2

#### MASA DISIPLINORE

Nga Hetimi administrativ i APP-së	Nga auditimet e KLSH-së	Nga Auditet e Brendshme të Autoriteteve	Nga vendimet e KPP-së
9	21	5	5

Rastet, në të cilat, është kërkuar plotësim dokumentacioni kanë qënë ende në proces në fund të vitit 2013.

Në katër rastet, që është kërkuar rishikim vendimi, APP-ja i ka qëndruar vendimit të saj në tre raste dhe ka revokuar vendimin e dhënë vetëm në një rast.

## 6.1.4. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë

Një kompetencë tjetër ligjore e APP-së, që është ushtruar nëpërmjet kësaj drejtorie gjatë vitit 2013, ka qënë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore/operatorëve ekonomikë, për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi apo procedura ankandi për një periudhë të caktuar kohore.

Konkretisht, gjatë vitit 2013 u morën në shqyrtim 19 propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga të cilat në përfundim të procedimit administrativ 6 (gjashtë) operatorë ekonomikë janë përjashtuar nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime. Nga këta:

2 Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale,

sipas përcaktimeve të nenit 13/3/ç të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

4 Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Vendimet e APP-së për përjashtimin e operatorëve ekonomikë për 3 raste janë ankimuar në rrugë gjyqësore dhe vazhdon procesi në vitin 2014.

- Për 12 operatorë ekonomikë, kërkesa e paraqitur është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshem për fillimin e procedimit administrativ; Në formë tabelore të dhënat e mësipërme paraqiten si më poshtë:

### TOTALI 19 kërkesa për përjashtim

Vendime përjashtimi	Vendime mos përjashtimi	Kërkesa për plotësim dokumentacioni	Ankimuar në gjykatë
6	12	1	3 nga 6 vendimet e përjashtimit

## 6.1.5. Monitorimi i procedurave të prokurimit sipas planit të APP-së:

Gjatë vitit 2013 Agjencia e Prokurimit Publik, në zbatim të detyrës së monitorimit, sipas ndryshimeve më të fundit në ligjin e prokurimit publik, ka hartuar një plan afatshkurtër monitorimi dhe e ka ushtruar këtë detyrë në dy drejtime kryesore:

### ➤ Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Janë monitoruar gjithsej 22 procedura prokurimi me vlerë të vogël, për të cilët është vendosur:

në 20 raste vendime për mbyllje hetimi, me tërheqje vëmendje në zbatimin e drejtë të

1. Monitorimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël;
2. Monitorimi i procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit. Nga monitorimi i procedurave si më sipër rezulton se:

legjisacionit të prokurimit publik; dhe në 2 raste është kërkuar dokumentacion dhe monitorimi është ende në proces.

## ➤ Për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

U është dërguar shkresa për monitorim 16 AK-ve.  
Është kërkuar informacion për 55 procedura.  
Është marrë vendim për 1 procedurë prokurimi.

Në proces monitorimi për 54 procedura prokurimi.  
Në formë tabelore të dhënat e mësipërme paraqiten si vijon:

### TOTALI 77 procedura në monitorim

Procedura prokurimi me vlerë të vogël	Procedura prokurimi me negociim pa shpallje	Procedura për të cilat është mbyllur monitorimi	Procedura për të cilat monitorimi është në proces
22	55	20 prokurime me vlerë të vogël dhe 1 negociim pa shpallje	2 prokurime me vlerë të vogël dhe 54 negociime pa shpallje

## 6.1.6. Veprimtaria e Drejtorisë në fushën e konçesioneve/ppp-ve

Një nga detyrat më të rëndësishme të drejtorisë juridike të monitorimit dhe publikimit në fushën e konçesioneve për këtë vit ka qenë bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me përfaqësues të SIGMA-s dhe grupet e interesit, për hartimin e ligjit nr.125/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat".

Për këtë arsye, janë zhvilluar disa tryeza pune me përfaqësues të SIGMA-s, me përfaqësues të Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Financave, ATRAKO-s, Bashkisë së Tiranës, përfshirë dhe operatorë ekonomikë. Pas miratimit të ligjit në fjalë nga Parlamenti, specialistët përkatës të Drejtorisë janë angazhuar për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij si nevojë e domosdoshme e plotësimit të kuadrit ligjor në këtë fushë. Në këtë kuadër janë hartuar dy projekt vendime, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave, përkatësisht me VKM nr. 576, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave

për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e konçesioneve për hidrocentralet", dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me konçesion/partneritet publik privat". Në vijim të plotësimit të kuadrit ligjor në këtë drejtim, nga drejtoria është hartuar seti i dokumentave standarde, i cili është miratuar me vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 19.07.2013 "Për miratimin e dokumentave standarde të konçesioneve dhe partneritetit publik privat për kontratat e shërbimeve dhe punëve publike".

Shfuqizimi i ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për konçesionet" me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 125/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat", si dhe futja e konceptit të ri të partneritetit publik privat si një formë e prokurimit të fondeve publike, solli fokusimin e punës në dhënien e mendimeve, këshillave, udhëzimeve apo tërheqje vëmendje për autoritetet kontraktore në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit të ri në varësi të fazës në të cilën ndodhej një procedure.

## 6.1.7. Statistika në lidhje me procedurat konçesionare

Gjatë vitit 2013, në sistemin e prokurimit elektronik janë shpallur për tu zhvilluar nga autoritetet kontraktore gjithsej **74 procedura konçesionare** dhe **2 procedura partneriteti publik privat**. Nga këto, për 22 procedura është botuar në Buletinin e

Njoftimeve Publike formulari i njoftimit të lidhjes së kontratës, për 14 prej tyre është botuar njoftimi i anulimit të procedurës, dhe 40 procedura janë në proces. Në formë tabelore këto të dhëna paraqiten si më poshtë:

## PROCEDURA KONÇESIONARE

Autoriteti Kontraktor	Të përfunduara	Në proces	Të anuluar
Ministria e ekonomisë dhe industrisë (ish METE)	19	36	11
Ministria e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave(ish MM)	-	1	-
Ministria e financës	1	1	-
Ministria e transportit dhe infrastrukturës(ish MPPT)	1	2	1
Bashkia Himarë	1	-	-
<b>Në total</b>	<b>22</b>	<b>40</b>	<b>12</b>

## PROCEDURA PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT

Autoriteti Kontraktor	Të përfunduara	Në proces	Të anuluar
Bashkia Elbasan	-	-	2
<b>Në total</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2</b>

### 6.1.8. Veprimtaria e Drejtorisë në drejtim të publikimit

Në Buletinin e Njoftimeve Publike janë botuar njoftime kontratash për procedurat e shpallura të prokurimit, njoftimet e fituesit, njoftimet e kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimit të procedurave të prokurimit, njoftimet për koncesionet, ppp-të dhe ankandet si dhe njoftime të tjera ku vendin kryesor e zënë njoftimet e administratës publike. Gjatë vitit 2013 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar **52** Buletine të Njoftimeve Publike me **17.838** faqe në total, ose mesatarisht **343** faqe për Buletin.

Buletini i Njoftimeve Publike është publikuar vetëm në formë elektronike.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike, punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, ditën e

nesërme të punës, sikurse e kërkon legjislacioni. Konkretisht gjatë vitit 2013 janë miratuar për publikim **4152** njoftime kontratash. Po kështu një rol shumë të rëndësishëm ka pasur funksioni i publikimit në lidhje me miratimin për publikim të njoftimeve të fituesit. Në këtë rast është bërë një koordinim dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit. Gjatë vitit 2013 është ndjekur në sistem zbatimi i rreth 1250 vendimesh të KPP-së dhe janë miratuar për publikim **3439** njoftime fituesi. I njëjti funksion është kryer dhe për miratimin për publikim të njoftimeve të kontratave të nënshkruara në sistem. Konkretisht janë miratuar për publikim **3762** njoftime kontratash të nënshkruara, si dhe janë publikuar **1713** njoftime kontratash të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake.

## 7. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E NJOFTIMEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË SHPALLURA GJATË VITIT 2013

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2013 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP-së është 4152, nga të cilët:

### NJOFTIME PROCEDURASH JANAR - DHJETOR 2013

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të fituesve	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të fituesve	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të fituesve
E hapur Ndërkombëtar		E hapur Ndërkombëtar	4	E hapur Ndërkombëtar	
Procedurë e hapur	288	Procedurë e hapur	628	Procedurë e hapur	331
Kërkesë me propozim	549	Kërkesë me propozim	1075	Kërkesë me propozim	492
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar	72	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar	
I kufizuar mbi kufirin e lartë monetar		I kufizuar mbi kufirin e lartë monetar		I kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	
<b>Totali</b>	<b>909</b>	<b>Totali</b>	<b>1707</b>	<b>Totali</b>	<b>823</b>

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik është **3762**, nga të cilët:

### NJOFTIME KONTRATASH TË NËNSHKRUARA JANAR - DHJETOR 2013

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruara
E hapur Ndërkombëtar		E hapur Ndërkombëtar	151	E hapur Ndërkombëtar	
Procedurë e hapur	274	Procedurë e hapur	1032	Procedurë e hapur	315
Kërkesë me propozim	488	Kërkesë me propozim	976	Kërkesë me propozim	454
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar	72	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar	
E kufizuar Ndërkombëtar		E kufizuar Ndërkombëtar		E kufizuar Ndërkombëtar	
<b>Totali</b>	<b>834</b>	<b>Totali</b>	<b>2159</b>	<b>Totali</b>	<b>769</b>



Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezultojnë se numri total i procedurave të shpallura në sistemin elektronik janë 4152, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuar në sistemin) është 3439. Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistemin, shpjegohet me faktin se disa nga procedurat e shpallura janë anuluar (për arsye të ndryshme), ose janë procedura të cilat janë shpallur në fund të vitit 2013 dhe nuk janë përfunduar ende me njoftimin e fituesit (janë në proces).

Gjithashtu po nga tabelat më sipër rezultojnë se numri i kontratave të nënshkruara është më i madh se numri i fituesve. Kjo diferencë shpjegohet me faktin se disa procedura janë

zhvilluar në mënyrë të përqëndruar (nga Organi Qendror Blerës, ose Ministri të ndryshme që kanë shërbyer si organ qendror për institucionet e veta të varësisë), dhe në këtë rast, fituesi është një, kurse kontrata të nënshkruara janë aq sa është dhe numri i institucioneve përfituese nga kjo procedurë.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar dhe **1713**, kontrata të nënshkruara për procedura me negociim pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2013, janë si më poshtë:

### PROCEDURA PROKURIMI TË ZHVILLUARA NË SISTEMIN ELEKTRONIK JANAR - DHJETOR 2013

Numri total i procedurave të publikuara	4,152
Fondi total limit i procedurave të publikuara	52,181,980,979
Numri total i procedurave të cilat kanë vazhduar	3,520
Fondi total limit i procedurave të cilat kanë vazhduar	48,617,647,873
Numri total i procedurave të papërfunduara (anulluar, etj)	632
Fondi total limit i procedurave të papërfunduara (anulluar, etj)	3,564,333,106
Numri total i procedurave të fituara	3,439
Fondi total limit	43,922,603,793
Fondi total i prokuruar	40,701,653,730
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	92.7%
Fondi total i kursyer	3,220,950,063
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	7.3%

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2013, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Numri total i procedurave të shpallura	4,152
Fondi total limit i procedurave të shpallura	52,181,980,979
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi nr	77
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi në vlerë	523,965,878
Negocim me shpallje ndërkombëtar nr	



Negocim me shpallje ndërkombëtar vlerë	
Negocim me shpallje lokal nr	1
Negocim me shpallje lokal vlerë	766,667
I hapur ndërkombëtar nr	3
I hapur ndërkombëtar në vlerë	3,827,503,317
I hapur lokal nr	1,316
I hapur lokal në vlerë	41,584,833,923
Kërkesë për propozim nr	2,752
Kërkesë për propozim vlerë	6,241,512,516
I kufiziar lokal nr	3
I kufiziar lokal vlerë	3,398,658

Në formë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprahe të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer per vitin 2013 janë si më poshtë:

## **PROKURIME ELEKTRONIKE DHE PROCEDUARA NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAHE TË NJOFTIMIT PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2013**

Numri total i procedurave të publikuara elektronike	4,152
Fondi total limit i procedurave të publikuara elektronike	52,181,980,979
Numri total i procedurave të fituara elektronike	3,439
Fondi total limit i procedurave të fituara elektronike	43,922,603,793
Fondi total i prokuruar i procedurave të fituara elektronike	40,701,653,730
Numri total i procedurave të fituara negoc pa shpallje	1,713
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	8,459,515,339
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	8,202,656,551
% që zë numri i procedurave të fituara negoc pa shpallje ndaj numrit total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	33.2%
% që zë fondi limit i procedurave me negoc pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik+negocim pa shpallje) për proceduar e fituara	16.4%
% që zë fondi i ofruar procedurave me negoc pa shpallje ndaj fondit total (elektronik+negocim pa shpallje) për proceduar e fituara	16.8%
Numri total i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	5,152
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	52,382,119,132
Fondi total i ofruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	48,904,310,281
% që zë fondi i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	93.4%
Fondi total i kursyer	3,477,808,851
% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	6.6%

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2013 janë si më poshtë:

## TË DHENA PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË ZHVILLUARA DHE TË PËRFUNDUARA ME FITUES JANAR - DHJETOR 2013

Llojet e Procedurave	Numri total i procedurave	Fondi limit total prokuruar	Fondi total i ofruar (tenderuar)	% që zë fondi i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur Ndërkombëtare (njoftim fituesi)	4	2,740,219,244	2,604,075,390	95.0%	136,143,854	5.0%
Procedurë e hapur (njoftim fituesi)	1,247	36,429,951,529	33,771,364,161	92.7%	2,658,587,368	7.3%
Kërkesë me propozim (njoftim fituesi)	2,116	4,472,180,120	4,052,808,673	90.6%	419,371,446	9.4%
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi (njoftim fituesi)	72	280,252,901	273,405,506	97.6%	6,847,395	2.4%
I kufizuar mbi kufirin e lartë monetar						
Procedurë negociim me shpallje paraprake ndërkombëtar						
<b>Totali</b>	<b>3,439</b>	<b>43,922,603,793</b>	<b>40,701,653,730</b>	<b>92.7%</b>	<b>3,220,950,063</b>	<b>7.3%</b>

## 8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2013, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka bërë përmirësime të ndjeshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit, sidomos në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri. Një nga detyrat më kryesore të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit gjatë këtij viti ka qenë implementimi në sistem i prokurimit me vlerë të vogël, duke përfshirë edhe trajnimin e përdoruesve, suportin teknik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë dhe ndjekjen e problemeve teknike deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre. Detyrat të tjera të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit kanë qenë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit duke siguruar kushte sa më të mira pune për të gjithë përdoruesit online të Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe të Sistemit të Arkivës Elektronike.
- Rritja e kapaciteteve hardware veçanërisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik duke u mundësuar

të gjithë përdoruesve një ambient të qëndrueshëm dhe të sigurtë pune. Këtu mund të përmendim përmirësimin e Arkivës Elektronike, në mënyrë që të realizohet transferimi i procedurave të cilat kishin më shumë se një vit online, nga databaza operacionale drejt asaj arkivë. Në këtë mënyrë u realizua kalimi i procedurave të përfunduara në arkivë nga baza e të dhënave operacionale si dhe optimizimi i kësaj të fundit.

- Zhvillimi i funksionaliteteve të sistemit për përmirësimin e pikave ku shfaqeshin pengesa brenda bazës së të dhënave, të cilat sillnin vonesa në punën e përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik.

- Projekti i Enkriptimit të të dhënave në procedura duke rritur sigurinë dhe përmirësuar funksionalitetet solli rritjen e standarteve në përdorimi e Sistemit të Prokurimit Elektronik.

- Bashkëpunim me institucionet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e sigurisë. Ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e sigurisë për

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

- Përmirësimi i faqes zyrtare të internetit të APP-së, e cila është pasuruar me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit nëpërmjet publikimit të materialeve si më poshtë:

- Publikimi i **52** buletinëve javorë.
- Publikimi i legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzimeve, raporte, module trajnimesh etj, në total **37 dokumenta**.
- Publikimi i **25** njoftimeve të ndryshme të aspektit teknik, në lidhje me funksionimin e sistemit.

Disa nga pikat kyçe të cilave u është kushtuar një rëndësi e veçantë dhe e përherëshme, janë:

- Monitorimi i infrastrukturës fizike të Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe Sistemit të Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i performancës së komponentëve hardware në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i performancës së aplikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike.
- Monitorimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike.

- Kryerja e Backup –it si dhe ruajtja e tij në Datacenter-in e AKSHI –it.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe Sistemit të Arkivës Elektronike.

Një sfidë e madhe me të cilën përballlet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit është mbajtja “online” e sistemit të prokurimit elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një peirudhë të caktuar, të nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse, paralajmërohet me anë të një njoftimi. Qëndrimi në gadishmëri jashtë orarit zyrtar të punës gjatë fundjavës si dhe ditëve të cilat janë festa zyrtare i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, duke monitoruar ecurinë e punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës kanë qënë në total rreth 2408 orë për vitin 2013.

Nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit janë bërë 436 orë pune përmirësimi software dhe hardware në dhomën e serverave kryesisht pas orarit zyrtar të punës si dhe në fundjavë.

Rezultati i punës së Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ka qënë administrimi i sigurt i një totali të dhënash prej:

561 GB (602,749,889,024 bytes) të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe  
4.78 TB (5,260,529,421,824 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike.

## 8.1 Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP-së

**M**bështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-ëve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP-së, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave të marra nga drejtoria ka qënë rreth 60 telefonata në ditë.

Gjatë vitit 2013 nga Drejtoria e IT-së:

- Janë përgatitur 1983 shkresa në total, ku përfshihen:
- Krijim llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjëndje fillestare;
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;

- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit në APP;
- 

Janë dërguar 4262 e-maile në total drejtë: operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjëndjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa); autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik); institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga kjo drejtori është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuar nga APP, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e sistemit elektronik të prokurimeve.

Në kuadër të asistencës për përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik ka qënë dhe bashkëpunimi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për të realizuar procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Në kuadër të këtij bashkëpunimi Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë vitit 2013 zhvilloi dy procedura prokurimi në sistemin elektronik dhe konkretisht: procedurën “Construction of Velabishti New Bridge, river training and retaining walls” në të cilën numri i ofertave të dorëzuara ishte 10, dhe procedurën “Asphalt pavement of road Shetaj – Kisha e Skënderbeut” në të cilën numri i ofertave të dorëzuar ishte 4.

Gjatë vitit 2013 Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka punuar intensivisht me

Drejtorinë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit për krijimin dhe përmirësimin e manualeve dhe udhëzimeve për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik, të cilat janë përshkruar më sipër, në këtë analizë. Këto udhëzime janë shumë të detajuara dhe me pamje nga sistemi, duke ndjekur teknikisht çdo fazë të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, parë nga të gjithë rolet e përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së IT-së me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit ka qënë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

## 8.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2013

Për vitin 2013 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar, 13428 përdorues të rinj dhe përkatësisht:

- Në rolin e “Administratorit të Sistemit për Autoritet Kontraktore” janë krijuar 728 llogari përdoruesi.
- Nga llogaria e “Administratorit të Sistemit për Autoritet Kontraktore” janë krijuar 12700 llogari përdoruesi në rolin e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit.


Nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2013 janë krijuar 728 llogari “Administrator” për Autoritetet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Numri total i Autoriteteve Kontraktore që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik shkon në 2101.

Nga këto Autoritete Kontraktore gjatë vitit 2013 janë krijuar:

- 5890 llogari përdoruesi për anëtarët e Njesisë së Prokurimit,
- 6444 llogari të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave,
- 366 llogari të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit.

Aktualisht numri total i përdoruesve nga autoritet kontraktore është 29626.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitet 2011, 2012 dhe 2013. Nga figura shihet qartë numri shumë i madh i përdoruesve të krijuar në vitin 2013, krahasuar me vitet 2011 dhe 2012 dhe kjo diferencë shpjegohet me kryerjen për herë të parë gjatë vitit 2013 të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në formë elektronike.




Për vitin 2013, në sistemin e prokurimit elektronik në rolin e operatorëve ekonomikë janë regjistruar 1576 operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët 38 janë operatorë ekonomikë të huaj.

- Në diagramën e mëposhtme paraqitet numri i përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik, nga operatorët ekonomikë, të

krijuar përkatësisht në vitet 2011, 2012 dhe 2013. Edhe në këtë rast vihet re qartë numri shumë i madh i përdoruesve të krijuar në vitin 2013, krahasuar me vitet 2011 dhe 2012 dhe kjo diferencë, sikurse thënë dhe më sipër, shpjegohet me kryerjen për herë të parë gjatë vitit 2013 të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në formë elektronike.

### OPERATORË EKONOMIKË TË RINJ NË SPE



Puna e përditshme e Drejtorisë së IT konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP-së

si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.

## 8.3 Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik


**N**umri total i aplikimeve të krijuara nga Njësitë e Prokurimit pranë Autoriteteve Kontraktore për vitin 2013 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është 34 822. Nga këto:

- 18996 janë aplikime për Blerje me Vlerë të Vogël;
- 15826 janë aplikime për procedurakonsulente, konkurs projektimi, procedura me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, procedura

të hapura, kërkesë për propozim, Procedura të kufizuara, mbi dhe nën kufirin e lartë monetar.

- Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave mbi vlerën 400.000 lekë, ku sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

## RAPORTI I PROCEDURAVE MBI VLERËN 400,000 LEKË, ME PROKURIMET ME VLERË TË VOGËL




### 8.4 Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik

Gjatë vitit 2013 janë krijuar këto aplikime nga operatorët ekonomikë, në spe:

93687	aplikime të krijuara
86019	oferta të konfirmuara
74722	oferta të kualifikuaraE
1129	oferta të pakualifikuara


Më poshtë jepet një diagramë e cila paraqet raportin e ofertave të konfirmuara nga Operatorët Ekonomikë, ndaj atyre të pakonfirmuara:

## RAPORTI I OFERTAVE TË KONFIRMUARA NGA OPERATORËT EKONOMIKË, ME ATO TË PAKONFIRMUARA



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet raporti i Ofertave të kualifikuara nga Komisionet e Vleresimit të Ofertave, ndaj atyre të skualifikuara.

## RAPORTI I OFERTAVE TË KUALIFIKUARA, NDAJ ATYRE TË SKUALIFIKUARA




## 8.5 Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë loguar Count. për vitin 2013 në total

23912 IP  
344162 Total Count



Grafiku i mëposhtëm pasqyron shpërndarjen sipas muajve të IP-ve të loguara si dhe Total


	Adresa IP	Total IP	Total Count
1	Janar, 2013	1233	12405
2	Shkurt, 2013	1550	19993
3	Mars, 2013	2117	33142
4	Prill, 2013	2479	49833
5	Maj, 2013	2628	39540
6	Qershor, 2013	2132	31657
7	Korrik, 2013	2068	28590
8	Gusht, 2013	1705	19413
9	Shtator, 2013	1862	24110
10	Tetor, 2013	1914	30157
11	Nëntor, 2013	1919	24361
12	Dhjetor, 2013	2305	30961
	<b>Totali</b>	<b>23912</b>	<b>344162</b>






Ditet e javës	Hits
e diel	6,258,255
e hënë	42,691,154
e martë	38,640,285
e mërkurë	40,024,425
e enjte	38,782,405
e premte	30,661,570
e shtunë	7,435,688
<b>Average</b>	<b>29,217,397</b>
<b>Totali</b>	<b>204,521,782</b>





**Page view per visit by month**




**Bounce rate by month**

## 8.6 Statistika në lidhje me përdorimin e Arkivës Elektronike të Sistemit të Prokurimit Publik

Gjatë vitit 2013, Sistemin e Arkivës Elektronike e kanë aksesuar në total 405 IP publike me një Total count 2793. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen statistikat e aksesimit të Sistemit të Arkivës Elektronike të Prokurimit Publik.

	Adresa IP	Total IP	Total Count
1	Janar, 2013	14	84
2	Shkurt, 2013	31	140
3	Mars, 2013	29	203
4	Prill, 2013	26	179
5	Maj, 2013	32	200
6	Qershor, 2013	26	137
7	Korrik, 2013	31	223
8	Gusht, 2013	28	145
9	Shtator, 2013	45	400
10	Tetor, 2013	51	375
11	Nëntor, 2013	53	327
12	Dhjetor, 2013	39	380
	<b>Totali</b>	<b>405</b>	<b>2793</b>



## 8.7 Statistika në lidhje me aplikimet e krijuara në sistemin e prokurimit elektronik dhe numri i prokurimeve me vlerë të vogël

Nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2013, janë asistuar 35 338 aplikime të krijuara nga Autoritetet Kontraktore nga të cilat 13 195 aplikime ndodhen në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ndërsa 22 143 aplikime ndodhen në Arkivën e Sistemit të Prokurimit Elektronik. Arkivimi i 22143 procedurave është asistuar nga kjo drejtori dhe ky arkivim është ekzekutuar gjithmonë natën, me qëllim mos pengimin e punës së përdoruesve (AK-të dhe Op.EK), gjatë ditës. Arkivimi i procedurave në orët e vona të natës nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka bërë që Sistemi i Prokurimit Elektronik të operojë në performancën maksimale

gjatë zhvillimit të procedurave duke rritur numrin e ofertave dhe reduktuar në maksimum problematikat. Kjo gjë vihet re edhe në numrin e ofertave të ofertuara nga operatorët ekonomikë ku gjatë vitit 2013 për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ka qënë në total 81 043 oferta. Ky ishte një nga sukseset e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2013. Në total gjatë vitit 2013 numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të shpallura në sistemin elektronik ka qënë 8799 procedura, nga të cilat 7197 janë përfunduar me fitues dhe 1602 janë anuluar.

Në formë tabelore të dhënat e mësipërme paraqiten:

### Procedura prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluara në SPE

Procedura të shpallura	Procedura të përfunduar me fitues	Procedura të anuluar
8799	7197	1602

Gjithashtu për procedurat e tjera numri i ofertave të ardhura në formë elektronike për vitin 2013 ka qënë 12 734, me një mesatare prej rreth 4 oferta për çdo procedurë.

## 9. TREGUESIT E VEPRIMTARISË NË DREJTIM TË INTEGRIMIT, MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS

Duke pasur parasysh:

Rëndësinë që kanë marëdhëniet me publikun, sidomos për prokurimet publike në kuadër të transparencës;

- Rëndësinë e madhe që kanë trajnimet për prokurimet publike, ku APP është institucioni përgjegjës për organizimin e seminareve në

fushën e prokurimit;

- si dhe detyrimin e përafritit të legjislacionit me Direktivat e BE-së për zgjidhjen dhe mbulimin e problemeve që dalin në kuadrin e integritit evropian, edhe puna në drejtim të menaxhimit të çështjeve të integritit, burimeve njerëzore dhe financës ka zënë një pjesë të rëndësishme në aktivitetin e APP-së për vitin 2013.

## 9.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Gjatë vitit 2013, Agjencia e Prokurimit Publik, e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me dy Drejtori kryesore; Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit. Për shkak të ndryshimeve të fundit legjislative dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 30.01.2013 "Për rialokimin e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2013, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit është shtuar me 3 specialistë (një nga të cilët është specialist i financës, i cili gjatë këtij viti ka ndryshuar varësinë, nga Drejtori i Përgjithshëm,

tek Drejtori i Drejtorisë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, duke e çuar numrin e nëpunësve në këtë drejtori në 11 dhe numrin total të APP-së, në 23.

Në muajin Janar është zhvilluar konkursi për pozicionin e punës "specialist koncesionesh" në Drejtorinë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit dhe në muajin Qershor është zhvilluar konkursi për pozicionin e punës "specialist" në Drejtorinë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit. Në muajin Maj është kthyer nga listë pritja një prej nëpunësve civil në pozicionin "specialiste monitorimi" në Drejtorinë Juridike, Monitorimit dhe Publikimit.

### KONKRETISHT, ORGANIKA E APP-SË GJATË VITIT 2013 ËSHTË SI MË POSHTË:

<b>I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM</b>	1
SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE DHE INTEG.)	1
ARKIVIST/PROTOKOLL	1
SHOFER	1
<b>II.DREJTORIA JURIDIKE, MONITORIMIT DHE PUBLIKIMIT (11)</b>	1
DREJTOR	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST (financa)	1
<b>III.DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT(8)</b>	1
DREJTOR	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
SPECIALIST	1
<b>NUMRI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>23</b>

## 9.2 Autoriteti Përgjegjës

**A**utoriteti Përgjegjës në institucion, ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë Deklarimet përkatëse.

Gjatë këtij viti Agjencia e Prokurimit Publik në përputhje me detyrimin ligjor "për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik", ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor të zyrtarëve ku nuk është identifikuar ndonjë rast i konfliktit të interesave, për punonjësit.

## 9.3 Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP-së dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore

### 9.3.1 Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

**N**ë kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2013 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Në datat 20-21 Mars 2013, dy përfaqësues të APP-së morën pjesë në konferencën "Për Prokurimin Elektronik" organizuar në Barcelonë, Spanjë.

Në datat 10-13 Prill 2013, një përfaqësues i APP-së mori pjesë në Konferencën IRSPM, me një prezantim mbi sistemin e prokurimit publik, në Panelin 40 "Vendi i Prokurimit Publik në Botë: Sfidat drejt Qëndrueshmërisë dhe Inovacionit" organizuar në Pragë, Çeki.

Në kuadër të zhvillimit të takimit të katërt të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Ministrinë e Integritetit kanë përfaqësuar institucionin më datë 26 Prill 2013 në Bruksel.

Më datat 14-16 Maj 2013, mbështetur në ftesën e Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme të

Zgjerimit, APP u përfaqësua në vizitën studimore me temë "Mbi zbatimin e Marrëveshjes Kuadër"-INT MARKT IND/STUD 51724, organizuar në Vjenë.

Agjencia e Prokurimit Publik, në datë 1 Maj 2013, me ftesë të Universitetit të Romës, Tor Vergata, u përfaqësua në një tryezë të rrumbullakët për prokurimin publik.

Mbështetur në ftesën e dërguar nga Byroja e Prokurimit Publik të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, në kuadër të zhvillimit të Forumit të Nëntë Rajonal për Prokurimin Publik, si dhe mbështetur nga Banka Aziatike për zhvillim (ADB), Banka Islamike për Zhvillim (ISDB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) si dhe Banka Botërore, dy përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik përfaqësuan institucionin në datat 28-31 Maj 2013 në këtë aktivitet.

Agjencia e Prokurimit Publik, në datat 20-21 Qershor, u përfaqësua në konferencën e gjashtë Rajonale për Prokurimin Publik, mbështetur nga OECD/SIGMA të organizuar në Danilovgrad, Maqedoni.

## 9.3.2 Trajnimet e stafit të APP-së

Stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik ka qënë pjesë e trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga ish-Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), me tematika të ndryshme në fushën e administratës publike.

Gjithashtu disa nga nëpunësit e rinj të APP-së, kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga vetë APP-ja në bashkëpunim me ish-ITAP-

in, në kuadër të ndryshimeve legislative dhe me zhvillimin e procedurave me vlerë të vogël online.

Gjatë muajit Prill 2013, disa nëpunës nga Agjencia e Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në trajnimet tre dhe dy ditore që u zhvilluan në kuadër të Projektit "Trajnimi në Prokurimin Publik, në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi".

## 9.3.3 Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë autoriteteve kontraktore.

Agjencia e Prokurimit Publik, me qëllim njohjen e punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në Autoritetet Kontraktore të pushtetit qendror dhe vendor, me ndryshimet që pësoi Legjislacioni i Prokurimit Publik dhe me mënyrën e kryerjes së prokurimeve me vlerë të vogël në formë elektronike organizoi në bashkëpunim me ish-ITAP-in, në periudhën Janar – Mars, 20 ditë trajnim 1 (ditor) në të cilin u përfshinë përfaqësues nga pushteti qendror dhe vendor si dhe institucionet e pavaruara.

Në 10 trajnimet e para morën pjesë nëpunës nga pushteti qendror duke përfshirë përfaqësues nga 15 ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë, dhe në përfundim të këtij cikli trajnimesh numri i të trajnuarëve ishte 364 punonjës.

Po kështu, në këtë periudhë, në bashkëpunim me Programin për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim në Qarkun e Shkodrës dhe Lezhës, APP zhvilloi

2 trajnime 2 ditore për përfaqësues të pushtetit vendor të Qarkut Shkodër dhe Lezhë.

Më tej bashkëpunimi vazhdoi përsëri me ish-ITAP-in për 10 seanca trajnimi për përfaqësues të pushtetit vendor. Numri i të trajnuarëve nga këto institucione ishte në 322 punonjës.

Pjesë e trajnimit me tematikë si më sipër ishin edhe institucionet e pavarura nga të cilët u trajnuan 40 punonjës.

Në muajin Korrik 2013, gjithashtu APP në bashkëpunim me SIGMA-n ka trajnuar në një trajnim një ditor 30 përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbi ndryshimet e kuadrit ligjor dhe raste të dala nga praktika.

Në formë tabelore të dhënat mbi institucionet e trajnuara dhe numrin e punonjësve të trajnuar, paraqiten si më poshtë:

Institucionet sipas kategorisë	Numri i të trajnuarëve
Institucione qendrore	364
Institucione të pavarura	70
Institucione vendore	322
<b>TOTALI</b>	<b>756</b>

Në kuadër të projektit "Trajnimi në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi", financuar nga BE, objektivi i të cilit ishte rritja e performancës

dhe profesionalizmit në sistemin e prokurimit publik, APP u angazhua në zhvillimin e 5 (pesë) temave të trajnimit konkretisht:

- 1- Prokurimi i punëve
- 2- Prokurimi i shërbimeve
- 3- Prokurimi i mallrave
- 4- Marrëveshja kuadër
- 5- Menaxhimi i kontratave

ishte dy ditore. Pjesmarrësit në këto trajnime ishin punonjës të pushtetit qendror dhe vendor të cilët kishin depozituar pranë APP-së nevojën për trajnim duke specifikuar temën e trajnimit.

Këto trajnime ishin respektivisht 3 ditore, me përjashtim të trajnimit me tematikë "Marrëveshja Kuadër", i cili

Në formë tabelore të dhënat mbi datat, vendin e zhvillimit të trajnimeve dhe numrin e pjesëmarrësve, paraqitet si më poshtë

Tema	Datat	Numri i pjesëmarrësve
Prokurimi i punëve	17-19 Prill, 2013	14
Prokurimi i Mallrave	22-24 Prill, 2013	12
Marrëveshja Kuadër	25-26 Prill, 2013	22
Prokurimi i Shërbimeve	06-08 Maj, 2013	27
Menaxhimi i kontratave	08-10 Maj, 2013	21
<b>Totali</b>		<b>96</b>

Numri total i të trajnuarve nga APP-ja gjatë vitit 2013 në bashkëpunim dhe me institucionet dhe organizatat e përmendura më sipër, ka qënë 852 specialistë të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

## 9.4. Integrimi

Sgjencisë së Prokurimit Publik ka qënë pNë vazhdimësi përgjatë këtij viti ka vijuar raportimi periodik pranë Ministrisë së Integritetit dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të Integritetit Evropian dhe detyrimeve që ky proces mbart përse i përket fushës së prokurimit publik.

Në datë 8 Mars 2013 u zhvillua në Bruksel takimi i rradhës së Komitetit të Stabilizimit Asociimit, ku Agjencia e Prokurimit Publik raportoi mbi progresin e arritur, në këtë fushë, për periudhën e kërkuar, kryesisht në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të tij, si dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të përfshirë në rregullimin dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Në datë 26 Prill 2013 u zhvillua në Bruksel takimi i përvitshëm i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri, për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, ku APP raportoi në mënyrë më të detajuar mbi progresin e arritur, përse përmendur më sipër.

Gjithashtu, në kuadër të rekomandimeve të nxjerra nga ky takim, u hartua një plan pune në adresim të këtyre rekomandimeve, për të cilat

APP ka raportuar në vijimësi pranë Ministrisë së Integritetit.

Ndërkohë, është përgatitur në nivel kapitulli kontributi për raportin e progresit 2013 të Komisionit Evropian, për Shqipërinë, në fushën e prokurimit publik, ku për kapitullin 5 "Prokurimi publik", APP është institucioni koordinues.

Në këtë drejtim, në vijim të raportimeve, si më sipër, të cilat kanë pasqyruar reformat e ndërmara në fushën e prokurimit publik, Komisioni Evropian, në raportin e progresit 2013, për Shqipërinë, konstatoi përmirësime dhe progres të mirë në këtë fushë. Në raport përmendet progresi i arritur me miratimin e ndryshimeve më të fundit në ligjin e prokurimit publik (Ligji nr. 131/2012), me qëllim përafrimin e tij të mëtejshëm me legjislacionin respektiv të Bashkimit Evropian, shoqëruar me përgatitjen dhe miratimin e ndryshimeve përkatëse në legjislacionin dytësor.

Gjithashtu, në raport konstatohet rëndësia e miratimit të ligjit të ri për koncesionet dhe partneritetin publik privat (Ligji nr. 125/2013), i ndjekur nga miratimi i legjislacionit dytësor



në këtë fushë. Në raport përmenden gjithashtu edhe masat e ndërmarra nga Agjencia e Prokurimit Publik në kuadër të sigurimit të transparencës së procedurave të prokurimit publik, nëpërmjet shtrirjes së aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik edhe për prokurimet me vlerë të vogël.

Ndërkohë, rekomandimi kryesor në progres raportin si më sipër, mbetet forcimi i kapacitetit të APP-së dhe autoriteteve kontraktore, për të siguruar zbatimin me efektivitet të legjislacionit të ndryshuar.

Në kuadër të përgatitjes së draft-ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, përpara dërgimit për miratim, u përgatitën edhe tabelat përkatëse të përputhshmërisë, të cilat përcaktojnë shkallën e përjasjes së secilit nen me pjesët e legjislacionit të Bashkimit Evropian që për afrohen.

Gjatë këtij viti, APP ka punuar edhe për plotësimin e një pyetësori (Fact Finding Fiche), të dërguar nga shërbimet e Delegacionit të Bashkimit Evropian, në Tiranë, nëpërmjet Ministrisë së Integritetit, në kuadër të perspektivës së re financiare të Bashkimit Evropian -IPA II (2014-2020), dhe ku sektori i prokurimit publik ishte një ndër të përzgjedhurit për vlerësim në këtë drejtim. Ky pyetësor u detajua sipas pyetjeve të përcaktuara në 7 seksione: Politika dhe Strategjia; Vlerësimi Institucional; Koordinimi ndërmjet Sektorit dhe Donatorëve; Analiza e Buxhetit; Sistemi i Monitorimit të Sektorit; Idetë e para për ndërhyrje; dhe Lista e dokumenteve dhe raporteve.

Në muajin Maj 2013, Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim me SIGMA-n, ka filluar të punojë për përgatitjen e një strategjie mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, objektivi i së cilës është të përcaktojë qëllimet kryesore në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimeve dhe masat e nevojshme për realizueshmërinë e tyre. Këto qëllime dhe masa respektive po punohen në kuadër të procesit të Integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe në linjë me proceset e vazhdueshme në nivel të BE-së, në lidhje me prokurimin publik. Edhe gjatë këtij viti, APP ka raportuar pranë Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në lidhje me zbatimin e masave të institucionit, të ndërmarra në zbatim të Rekomandimit nr. 8 "Strategjia dhe Plani i Veprimit Antikorrupsion".

Gjithashtu, Agjencia e Prokurimit Publik ka

raportuar edhe pranë Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në kuadër të iniciativës Open Government Partnership. Ky raportim kishte për qëllim dhënien e informacionit për secilin angazhim ku APP është përgjegjëse, në lidhje me situatën e përmbushjes së tyre.

Gjatë vitit 2013, APP ka përditësuar edhe pyetësoarin e vetëvlerësimit, të përgatitur në kuadër të Raportit të Vlerësimit (2010) për prokurimin publik, të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky përditësim kishte për qëllim reflektimin e progresit të reformave që prej vitit 2010, marrë në konsideratë zhvillimet më të fundit legjislative në këtë fushë.

Si anëtare e grupit të punës, të udhëhequr nga ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për vetëvlerësimin e politikave të Aktit të Biznesit të Vogël, Agjencisë së Prokurimit Publik i është kërkuar, edhe gjatë vitit 2013, të vlerësojë implementimin e politikave në kuadër të Aktit të sipërcituar, të ndërmarra nga institucioni, në fushën e prokurimit publik.

Po në kuadër të një studimi të Komisionit Evropian, mbi aksesin e Bizneseve të Vogla dhe të Mesme në prokurimin publik, APP-së i është kërkuar informacion për parashikimet e legjislacionit shqiptar për prokurimin publik, në lidhje me këtë akses.

Në muajin Nëntor, përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik morën pjesë në takim të dytë të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike, i udhëhequr nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë të cilit, përsa i përket fushës së prokurimit publik, u raportua mbi reformat më të fundit të ndërmarra në këtë fushë, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit, ashtu edhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të prokurimeve.

Në përfundim të këtij takimi, përfaqësues të Komisionit Evropian, pjesëmarrës në takim, mirëpritën progresin e arritur, në këtë fushë, gjatë vitit 2013, si dhe theksuan rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të institucioneve rregullatore të prokurimit publik. Gjithashtu, nga përfaqësuesit e Komisionit Evropian u theksua se burimet njerëzore të institucioneve, përsa më sipër, duhet të jenë në proporcion me funksionet përkatëse të tyre, me qëllim sigurimin e efektivitetit të këtyre institucioneve.

## 9.5. Gjëndja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2013

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit nr.119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", ka marrë fonde nga buxheti i shtetit, si më poshtë:

Në 000/lekë						
Emërtimi	Plan vjetor 2013	Akt normativ 2013	Fakt 2013	Në %	Në vlerë	
1 Shpenzime paga	19 506	19 506	19 078	97.8	428	
2 Sigurime Shoqërore	3 348	3 348	3 029	90.5	319	
3 Mallra Shërbime	27 930	19 082	18 680	97.9	402	
4 Transferta List pritje	0	0	0	0		
5 Shpenzime përinvestime	8 000	8 000	7 028	87.9	972	
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>58 784</b>	<b>49 936</b>	<b>47 815</b>	<b>95.8</b>	<b>2 121</b>	

Konkluzioni kryesor që nxirret nga analizimi i tabelës është se shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të vitit 2013, janë realizuar në masën 95.8 përqind, ose rreth 2 121 000 lekë më pak se plani i ndryshuar në fund të vitit.

Struktura	Buxheti2013
1 Paga	39
2 Sigurime Shoqërore	6.7
3 Mallra Shërbime	38.2
4 Shpenzime kapitale	16
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>49 936</b>

Bazuar në VKM nr. 591, datë 10.07.2013, "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013", dhe duke patur parasysh që fondi i akorduar nga buxheti në fillim viti për shpenzime operative, në krahasim me kërkesat tona buxhetore, ishte rreth 6 milion lekë më tepër, nga buxheti i rishikuar sipas Aktit normativ nr.6, datë 04.10.2013, shpenzimet operative u reduktuan, përkatësisht në shumën 8 848 000 lekë.

Shpenzimet me fondet e buxhetit u realizuan në zërin shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore përkatësisht 97.8% dhe 90.5%, ndërkohë që shpenzimet operative u realizuan 97.9%, dhe në investime 87.9%.

Peshën kryesore në shpenzimet operative e zë zëri shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit, në nivelin 74% të totalit të shpenzimeve të planifikuara, ose 75.5% të shpenzimeve të realizuara.

Investimet nga 8 000 000 lekë fonde të akorduara në fillim të vitit u realizuan 87.9%. Është për t'u theksuar fakti se në kursimin e fondeve të shpenzimeve operative ka ndikuar edhe kryerja e procedurave online për prokurimet me vlerë të vogël.

Përsa i përket kontabilitetit dhe mbajtjes së llogarive sintetike dhe analitike, veprimet

kontabël janë kryer konform dispozitive ligjore në fuqi, edhe detyrimet debitore dhe kreditore janë ndjekur sistematikisht.

Llogaria "Furnitorë e llogari të lidhura me to" rezulton me gjendje në shumën 1 507 813 lekë

ndaj Tipografisë Grafon dhe nuk është likuiduar pasi çështja është në proces gjyqësor. Fatura të papaguara për shërbime të kryera gjatë vitit nuk ka.

## 10. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT

Gjatë vitit 2013, përveç komunikimeve shkresore, nëpunësit e APP-së, u kanë dhënë shpjegime dhe këshilla përfaqësuesve të institucioneve dhe në takime të zhvilluara në ambjentet e APP-së. Gjatë këtij viti, nëpunësit e APP-së kanë pritur në takime

përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Këto takime janë zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm si dhe me përfaqësues të Drejtorisë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

## 11. PËRMBYLLJE

Nga analiza e punës së Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë vitit 2013 dhe angazhimet e saj në fund të vitit 2012, për vitin në vijim (të shprehura në analizën e vitit 2012), vihet re se këto angazhime janë përmbushur në pjesën më të madhe, edhe pse disa prej tyre ishin shumë ambicioze, sikurse ishte kryerja e procedurave të prokurimit me vlera të vogla në formë elektronike.

Përmbushja e këtyre angazhimeve vjen në të njëjtën linjë dhe me rekomandimet e shprehura në Progres Raportin e Komisionit Evropian në fund të vitit 2012. Kështu, gjatë vitit 2013 APP-ja ka përmbushur angazhimin dhe rekomandimin për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të koncesionit dhe partneritetit publik privat (ppp). Sikurse është përmendur dhe më sipër në këtë analizë, në Prill të vitit 2013 është miratuar ligji i ri për koncesionet dhe ppp-të, duke e sjellë atë më afër me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu gjatë këtij viti APP është angazhuar maksimalisht në plotësimin e kuadrit nënligjor të prokurimit publik, në referim të ndryshimeve të LLP-së, në fund të vitit 2012.

Edhe rekomandimi i KE-së për një mekanizëm të qartë dhe efektiv për monitorimin e procedurave të prokurimit, u zbatua gjatë vitit

2013 nëpërmjet një plani konkret monitorimi të fokusuar kryesisht në procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, sikurse analizuar në mënyrë të hollësishme më sipër në këtë analizë.

Po kështu në kuadër të rekomandimeve dhe angazhimeve të marra nga vetë APP-ja, si dhe rekomandimeve të KE-së, gjatë vitit 2013 u bënë përmirësime dhe në kuadër të kapaciteteve administrative, duke shtuar numrin e stafit të APP-së me 3 persona, në kuadër dhe të shtimit të funksionit të monitorimit, si dhe duke trajnuar rreth 900 përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me qëllim, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre, në funksion të mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit për të cilin raportohet, APP-ja, jo vetëm ka vazhduar të administrojë me sukses sistemin e prokurimit elektronik, duke bërë të mundur që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në të, por edhe ka arritur që të përmirësojë funksionalitetin e këtij sistemi sidomos në dy drejtime shumë të rëndësishme:

- së pari u bë i mundur realizimi edhe i procedurave të prokurimit me vlera të vogla nëpërmjet këtij sistemi, gjatë vitit 2013. Kjo

ishte një sfidë dhe arritje shumë e madhe për APP-në, pasur në konsideratë numrin shumë të lartë të procedurave të prokurimit me vlera të vogla të zhvilluar në SPE gjatë vitit 2013. Kjo iniciativë kërkoi impenjimin maksimal të APP-së nga pikëpamja teknike, ligjore si dhe e ngritjes së kapaciteteve administrative të AK-ve, në këtë drejtim.

- së dyti, edhe gjatë vitit 2013 është punuar për përmirësimin e arkivës elektronike. Zhvillimi edhe i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në SPE, kërkoi një vëmendje të veçantë në këtë drejtim, pasi u rrit në masë të konsiderueshme volumi i dokumentacionit në të.

Megjithatë puna për mirëmbajtjen e sistemit dhe administrimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e një sistemi të tillë nga Autoritetet Kontraktore si dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm, është ende një sfidë me të cilën APP-ja do të vazhdojë të përballet dhe gjatë vitit 2014.

Si tregues të rezultateve të punës së APP-së si dhe të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, janë dhe statistikave të gjeneruara nga sistemi elektronik i prokurimit, ku del qartë numri i procedurave të zhvilluara, numri i lartë i pjesëmarrësve, si dhe fondi i kursyer në këto procedura.

Të gjitha rezultatet e sipërpërmendura janë arritur, megjithë numrin relativisht të vogël të stafit, krahasuar me detyrat që ky institucion ka në bazë të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të konçesioneve dhe ppp-ve dhe legjislacionit të ankandit publik.

Arritjet në fushën e prokurimit publik gjatë vitit 2013 u vlerësuan pozitivisht edhe nga Komisioni Evropian në raportin e progresit 2013, për Shqipërinë, sipas të cilit u konstatuan përmirësime dhe progres i mirë në këtë fushë. Në raport vlerësohet si progres miratimi i ndryshimeve më të fundit në ligjin e prokurimit publik (Ligji nr. 131/2012), me qëllim përafrimin e tij të mëtejshëm me legjislacionin respektiv të Bashkimit Evropian, shoqëruar me përgatitjen

dhe miratimin e ndryshimeve përkatëse në legjislacionin dytësor.

Gjithashtu, në raport konstatohet rëndësia e miratimit të ligjit të ri për koncesionet dhe partneritetin publik privat (Ligji nr. 125/2013), i ndjekur nga miratimi i legjislacionit dytësor në këtë fushë si dhe rëndësia e masave të ndërmarra nga Agjencia e Prokurimit Publik në kuadër të sigurimit të transparencës së procedurave të prokurimit publik, nëpërmjet shtrirjes së aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik edhe për prokurimet me vlerë të vogël.

Megjithatë ngelen ende rekomandime që duhen përmbytur, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri dhe ndër më kryesori prej tyre, në progres raportin si më sipër mbetet forcimi i kapacitetit të APP-së dhe autoriteteve kontraktore, për të siguruar zbatimin me efektivitet të legjislacionit të ndryshuar.

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2013, për realizimin e detyrave dhe përmbyturjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, pasur në konsideratë dhe ato të nxjerra nga Progres Raporti i BE\_së, APP -ja ka një sërë prioritetesh, për të cilat duhet të punojë në vazhdim. Ndër to si më kryesoret theksojmë,

- Hartimin e një strategjie për sistemin e prokurimit publik në përgjithësi;
- Monitorimin e mirëmbajtjes së procedurave të prokurimit publik, procedurave koncesionare dhe ppp-të me qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurimit;
- Përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik në:
  - përmirësimin e arkivës elektronike;
  - rritjen e kapaciteteve të sistemit me qëllim mbarëvajtjen e të gjitha proceseve që zhvillohen në këtë sistem;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të punonjësve të Autoriteteve Kontraktore në këtë drejtim, e cila është një sfidë që ngelet gjithmonë e hapur, dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me implementimin në praktikë të marrëveshjes kuadër si dhe implementimin në praktikë të legjislacionit të ri të koncesioneve dhe ppp-ve.



